



NJOFTIM PËR PUNËSIM

Kërkohet një Përgjegjës Teknik me kohë të plotë sipas ligjeve në fuqi me kontributet shoqërore dhe shëndetsore

Kriteret e Punësimit të Përgjegjësit teknik të AFMM

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare për kinematografi dhe media.
2. Të flasë dhe shkruajë në gjuhën angleze.
3. Të ketë njohuri praktike dhe teknike të të gjithë dispozitivit teknik dhe pajisjeve të xhirimit të kinematografisë dhe medias si dhe pajisjeve të projeksionit.
4. Të ketë njohuri praktike dhe teknike të pajisjeve të montazhit të zërit dhe figurës si dhe të post-produksionit në tërësi.
5. Të ketë aftësi organizative dhe të punës në ekip.
6. Të ketë njohuri të funksionimit administrativ, institucional dhe akademik.
7. Kusht specifik i detyrës është gatishmëria shumë e lartë dhe mundësia e nevojës për punë gjatë mbrëmjes dhe fundjavave.

Detyrat e Përgjegjësit Teknik të AFMM

1. Zbatimi i Statutit dhe Regulloreve të AFMM.
2. Koordinimi i ngushtë dhe i plotë me Njësinë e Produksioneve nën varësinë e të cilës funksionon dhe me Këshillin Akademik dhe Drejtorinë Administrative të AFMM.
3. Mirëmbajtja, kategorizimi, inventarizimi, përditësimi dhe administrimi i parkut të pajisjeve të AFMM.
4. Organizimi dhe zbatimi teknik i të gjitha aktiviteteve kinematografike dhe kulturore të shkollës brenda dhe jashtë AFMM dhe në të gjithë vendin dhe për projekte të veçanta edhe jashtë shtetit.
5. Organizimi i lëvizjeve të aparaturave, organizimi i studiove të montazhit dhe mbështetja teknike e të gjitha produksioneve të fimave studentorë të AFMM në bashkëpunim me NJP, KA dhe DA.
6. Pjesëmarrja në programe të trajnimit, formimit dhe edukimit në vazhdim brenda dhe jashtë vendit.
7. Detyrat e PT të AFMM duhet të karakterizohen nga: Shpejtësi reaguese dhe parashikim. Aftësi në marrjen e nismave, autonomi. Aftësi për të qenë i gjithanshëm. Seriozitet dhe gjithëpërfshirje.

Të interesuarit të dërgojnë CV-in me email tek magali@afmm.edu.al